

Bujqësia e Kosovës në Numra

2021



Hyrja

Ofrimi i statistikave të qëndrueshme në mënyrë që të shërbejnë si një instrument për hartimin e politikave, strategjive zhvillimore si dhe hulumtimeve apo studimeve të ndryshme është prioritet i yni, andaj Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore (DAESB) është e përkushtuar të sigurojë qasje në të dhëna aktuale, të besueshme dhe në kohë, të nevojshme për të përcaktuar drejtimin e një sektori sa më stabil.

Bashkëpunimi me institucionet relevante që janë përgjegjëse për përgatitjen e statistikave zyrtare, përpunimi dhe prezantimi i statistikave konform kërkesave të MBPZHR është një ndër aktivitetet kryesore në mandatin e DAESB-ës, duke mbështetur në hartimin e raporteve, analizave, programeve dhe strategjive sektoriale si dhe dokumenteve tjera. Publikimi “Bujqësia e Kosovës në Numra” i përgatitur nga DAESB, ofron qasje të shpejtë dhe të lehtë në numrat dhe figurat që paraqesin një pasqyrim shumë dimensional të gjendjes së bujqësisë në Kosovë duke filluar nga statistikat e përgjithshme ku përfshihen të dhënat për Bruto Produktin Vendor, popullsinë, shkallën e papunësisë, të dhënat për statistikat kryesore bujqësore në Kosovë, Bruto Vlerën e Shtuar, pjesëmarrjen e bujqësisë në BPV, eksportin/importin bujqësor dhe pjesëmarrjen e tij në eksportin/importin e përgjithshëm si dhe bilancin tregtar, të dhëna për përdorimin e tokës të ndarë sipas klasave të përdorimit, të dhënat për madhësinë e fermës sipas numrit të ekonomive bujqësore dhe sipërfaqes së tokës së punueshme. Në publikim janë paraqitur edhe të dhënat mbi llogaritë ekonomike të cilat përfshijnë prodhimet e industrisë bujqësore dhe komponentët tjerë kryesorë të llogarive ekonomike, të dhënat për çmimet e inputeve dhe produkteve bujqësore, të dhënat për FADN - Rrjetin e të Dhënave të Kontabilitetit në Fermë, të dhënat për prodhimin bujqësor dhe blegtoral të cilat përfshijnë prodhimtarinë bimore, prodhimtarinë e verës, prodhimtarinë organike, materialin fidanor, blegtorinë si dhe disa indikatorë nga bilancet e furnizimit. Të dhëna tjera të paraqitura janë të dhënat mbi tregtinë e produkteve bujqësore të ndara sipas grupeve të produkteve kryesore bujqësore dhe sipas shteteve, të dhënat për agro kreditë si dhe të dhënat për përkrahjen e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural (pagesa direkte dhe masat e zhvillimit rural).

Përgjegjës për përgatitjen e këtij publikimi është DAESB, ndërsa si burim i informacionit në publikim janë njësitë organizative të MBPZHR-së, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB) dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Përmbledhje

Në vitin 2020 vlera e **Bruto Produktit Vendor** me çmime aktuale ishte 6,772 mil. €, duke rezultuar me BPV për kokë banori në vlerë prej 3,772 €. Shkalla e papunësisë në nivel vendi ishte 25.9%. Në vitin 2020, Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi kanë kontribuar me 7.4% në gjithsej Bruto Produktin Vendor.

Në vitin 2020 gjithsej **sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore** ishte 420,210 ha me një % të shpërndarjes si në vijim: Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët) me pjesëmarrje prej 52%, Tokë e punueshme-ara 43%, Perime (në fushë të hapur dhe serra si kulturë e parë), kopshte dhe fidanishte 2%, Plantacione të pemëve 2% si dhe Plantacione të vreshtave 1%.

Sa i përket **madhësisë së fermës** marr parasysh sipërfaqen e tokës së punueshme – arave, 35% e sipërfaqes është në ferma me madhësi prej 5 deri në më pak se 10 ha, 21% e sipërfaqes në ferma prej 2 deri në më pak se 5 ha, 16% e sipërfaqes në ferma me madhësi prej 1 deri në më pak se 2 ha dhe pjesa tjetër e sipërfaqes është tek madhësitë e tjera. Sa i përket numrit të fermave, 91% e tyre kanë sipërfaqe me pak se 5 ha, ndërsa si sipërfaqe këto ferma mbulojnë 46% nga gjithsej sipërfaqja e tokës së punueshme – arave.

Në vitin 2020 **vlera e prodhimeve të industrisë bujqësore** ishte 828.4 mil. €, prej të cilës 477.4 mil. € ishte vlera e prodhimeve bimore, 302.1 mil. € vlera e prodhimeve blegtorale, 30.0 mil. € vlera e shërbimeve bujqësore dhe 18.9 mil. € vlera e aktiviteteve të tjera dytësore jobujqësore (të pandashme). Vlera e prodhimeve bimore dhe blegtorale është rritur vazhdimisht nga viti 2018. Viti 2020 karakterizohet me vlerën më të lartë të prodhimeve bimore dhe blegtorale gjatë periudhës 2016-2020. Nëse i krahasojmë me vitin paraprak, rezulton se rritja ishte 8% për prodhime bimore dhe 3% për prodhime blegtorale.

Vlera e prodhimit të industrisë bujqësore në vitin 2020 ishte më e larta gjatë periudhës 2016-2020, e në krahasim me vitin paraprak, shënoi rritje për 6%. Sa i përket konsumit të ndërmjetëm, në vitin 2020 shënoi rritje për vetëm 4%.

Vlera e shtuar bruto e cila paraqet ndryshimin në mes të vlerës së prodhimit të industrisë bujqësore dhe vlerës së konsumit të ndërmjetëm, në vitin 2020 kishte vlerën 512 mil. €, ku krahasuar me vitin paraprak shënoi rritje për 7%. Në vitin 2020, vlera e shtuar bruto ishte e barabartë me 62% të vlerës së prodhimit. Vlera më e lartë e të hyrave në bujqësi ishte në vitin 2020 ku të

ardhurat sipërmarrëse ishin 9% më të larta se në vitin paraprak. Vlera e shtuar bruto dhe vlera e shtuar neto shënuan rritje për 7% dhe 9% respektivisht.

Indeksi vjetor i **çmimeve të inputeve** në vitin 2020 ka pësuar rënie për 3.2% për Input 1 (Mallrat dhe shërbimet e konsumuara aktualisht në bujqësi) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019, ndërsa indeksi për Input 2 (Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore) kishte rritje për 1.5%. Indeksi i çmimeve të inputit të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) krahasuar me vitin e 2019, në vitin 2020 ka rënë për 1%. Sipas kategorive të çmimeve të inputeve bujqësore, më së shumti rritje të çmimit në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 kishte nënkategoria “Lëndë të përbëra ushqimi” brenda kategorisë “Lëndë për ushqim kafshësh” për 11% dhe “Lubrifikantët” brenda kategorisë “Energjia: Lubrifikantët” për 7%. Rënie më të dukshme të çmimit në vitin 2020 ka pasur tek “Lëndët djegëse” brenda kategorisë “Energjia: Lubrifikantët” për 18% dhe “Produktet për mbrojtjen e bimëve dhe pesticidet” për 3%. Sa i përket çmimit të energjisë elektrike, nuk ka pasur fare ndryshim nga viti 2019, ndërsa çmimi i naftës ka rënë për 19%.

Në vitin 2020, **çmimet e prodhimeve bujqësore në nivel ferme** për produktet shtazore shënuan rritje në krahasim me vitin 2019 përfshirë edhe mjaltin ndërsa sa i përket çmimeve të produkteve bimore disa shënuan ngritje e disa të tjera ulje të çmimit. Rritja më e lartë të çmimit kishte kumbulla (në kuadër të grupit të pemëve), shalqiri, lakra, fasulja (tek perimet) dhe gruri (tek drithërat), ndërsa ulje e çmimeve prej 11 deri në 43% është shënuar te misri, domatja, speci, qepa, molla dhe dardha varësisht nga kultura.

Sa i përket **prodhimit bujqësor** viti 2020, pothuajse të gjitha kategoritë kanë pas rritje të prodhimtarisë nisur nga drithërat që kanë shënuar rritje për 15.2%, pemët 7.4%, vreshtat 36.3%, kulturat industriale mbi 100%, përveç perimeve ku prodhimtaria ka shënuar rënie për 3.3%. **Fondi i gjedheve** është rritur për 1.4%, si kategori më e rëndësishme në kuadër të blegtorisë e që përbën 47.5% të gjithëj krerëve blegtoral. Sa i përket dhenve dhe dhive për nga numri kjo kategori përbën 43.9% të gjithëj numrit të kafshëve në vitin 2020. Numri i dhenve dhe dhive në vitin 2020 ishte 241,688 krerë apo 11.7% më i lartë sesa në vitin 2019. Sipas kategorive numri i dhenve në vitin 2020 është rritur për 12.2% ndërsa numri i dhive për 8.7%. Sektori i derrave edhe pse më pak i zhvilluar krahasuar me sektorët tjerë ka shënuar rritje për 12%, kurse numri i kuajve, gomarëve dhe mushkave në vitin 2020 është zvogëluar për 233 krerë. Numri i përgjithshëm i shpezëve në Kosovë është rritur për 4.4%, nga numri i shpezëve, 94.8% janë pula ndërsa

pjesa tjetër prej 5.2% janë biba, rosa, pata dhe shpezë të tjera. Gjithsej prodhimtaria e vezëve është 366 mil. copë. Numri i koshereve të bletëve është rritur për 19.4% në vitin 2020, kurse prodhimtaria e mjaltit ishte shumë më e ulët sesa në vitin 2019, kjo si rezultat i kushteve të papërshtatshme atmosferike që ishin në vitin 2020, e që ndikoi që prodhimtaria të ishte mjaft e ulët.

Konsumi i prodhimeve bujqësore nuk ka pësuar ndryshime të mëdha në vitet e fundit, e për të plotësuar nevojat e përgjithshme për konsum, vendi ynë importon prodhime bujqësore. Sasia e importit varet nga prodhimtaria vendore në vitin përkatës e kjo reflektohet edhe tek **shkalla e vetëmjaftueshmërisë për prodhime bujqësore** e cila për disa nga prodhimet bujqësore më të kultivuara në vitin 2020 ishte si në vijim: Drithëra (Grurë 73% dhe Misër 75%), Perime (Domate 57%, Spec 87%, Patate 106%) dhe Pemishte e Vreshta (Molla 78%, Kumbulla 95%, Dredhëza 78%, Rrush tryeze 71%). Në sektorin e blegtorisë prodhimi i mishit të gjedhit e ka shkallën e vetëmjaftueshmërisë 52%, qumështi i lopës 80%, mishi i deleve dhe dhive 100%, vezët 99% dhe mishi i pulës 7%.

Në vitin 2020 **tregtia e produkteve bujqësore** është rritur për 2%, ku eksporti kishte rritje për 19% dhe importi për 1%. Eksporti i produkteve bujqësore kishte vlerë prej 78.1 mil. € apo pjesëmarrje 16.4% në eksporti e përgjithshëm përderisa importi shënoi vlerën 765.4 mil. € apo pjesëmarrje prej 23.2% në importin e përgjithshëm. Mbulueshmëria e importit me eksport është rritur në 10.2% nga 8.6% sa ishte në vitin 2019 dhe deficiti tregtar u zvogëluar për 1%. Në vitin 2020, pjesa më e madhe apo 52.7% e produkteve bujqësore të eksportuara është realizuar në vendet e CEFTA-s, 39.5% në vendet e BE-së dhe pjesa tjetër prej 7.8% në vendet e tjera. Për dallim nga eksporti, pjesë me e madhe e produkteve të importuara apo 53.7% është nga vendet e BE-së, pasuar nga vendet e CEFTA-s me 24.0% dhe vendet e tjera me 22.3%.

Gjatë vitit 2020, gjithsej shuma e **agro kredive** të disbursuara është 83.2 mil. € apo 27.7% më e ulët krahasuar me vitin paraprak, numri i kredive për Banka dhe IMF është rritur 6.2% ndërsa norma e interesit është zvogëluar tek bankat nga 9.1% (2019) në 8.5% (2020) ndërsa tek IMF-të nga 22.5% në 20.5%. Pjesëmarrja e agrokredive në raport me kreditë komerciale është duke u zvogëluar çdo vit, tani pjesëmarrja e tyre është vetëm 2.2%.

Në vitin 2020 ka vazhduar mbështetja e sektorit të bujqësisë bazuar në dy programet e hartuara: **Programin e Pagesave Direkte dhe Programin e Zhvillimit Rural**. Duke marr parasysh se në vitin 2020 vendi ynë si edhe çdo vend tjetër u përball me pandeminë

Covid-19, është implementuar edhe masa 4A (si masë e veçantë në kuadër të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike) për dyfishimin e buxhetit për Programin e Pagesave Direkte vetëm për vitin 2020, krahasuar me vlerat e vitit 2019, e që kjo masë kishte një buxhet në vlerë prej 24 mil. €.

Në vitin 2020 totali i mbështetjes përmes **pagesave direkte** ishte 67.1 mil. €. Krahasuar me vitin paraprak mbështetja është rritur më shumë se dyfishi e kjo ka ndodhur për shkak të dyfishimit të pagesave direkte për njësi në kuadër të PRE por edhe asaj se ka pasur rritje të njësive të subvencionuara tek disa sektorë të mbështetur. Gjithsej numri i fermerëve aplikues në vitin 2020 ishte 30,702, prej të cilëve ishin 28,489 fermerë përfitues (93%) dhe 2,213 të refuzuar (7%). Në vitin 2020, shuma më e madhe e subvencioneve ishte ndarë për grurin (21%), pasuar nga lopët qumështore (14%), misri (13%), bletë (10%), vreshta (9%) dhe pjesa tjetër prej 33% tek kulturat dhe sektorët e tjerë.

Buxheti i planifikuar në kuadër të **Programit të Zhvillimit Rural** për vitin 2020-2021 ishte 29.4 mil. €. Shuma e mjeteve të miratuara në vitin 2020 ishte 12.6 mil. € prej të cilave 56.5% e mjeteve ishin në kuadër të masës 101 (Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore), 29.2% në kuadër të masës 103 (Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore), 13.0% në kuadër të masës 302 (Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale) si dhe për masën Ujitja e tokave Bujqësore 1.3%.

Statistikat e përgjithshme

Të dhënat e përgjithshme për Kosovën

	2016	2017	2018	2019	2020
Bruto produkti vendor me çmime aktuale (mil. €)	6,037	6,356	6,672	7,056	6,772
BPV për kokë banori (€)	3,368	3,534	3,715	3,959	3,772
Popullsia e Kosovës (e vlerësuar)	1,783,531	1,798,506	1,795,666	1,782,115	1,798,188
Shkalla e papunësisë (%)	27.5	30.5	29.6	25.7	25.9


Burimi: ASK

Statistikat kryesore për bujqësinë në Kosovë

Bujqësia në ekonominë e vendit

	Ø 2010-2015	2016	2017	2018	2019	2020
Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi - Bruto Vlera e Shtuar me çmime aktuale (BVSH), (mil. €)	402.3	493.3	470.9	435.7	510.8	498.5
Pjesëmarrja e Bujqësisë në BPV (%)	12.1	8.2	7.4	6.5	7.2	7.4
Eksporti bujqësor (mil. €)	33.0	45.2	61.3	64.0	65.5	78.1
Pjesëmarrja e eksportit bujqësor në eksportin e përgjithshëm (%)	10.8	14.6	16.2	17.4	17.1	16.4
Importi bujqësor (mil. €)	574.6	658.7	694.5	712.3	759.4	765.4
Pjesëmarrja e importit bujqësor në importin e përgjithshëm (%)	23.2	23.6	22.8	21.3	21.7	23.2
Bilanci tregtar për produkte bujqësore (mil. €)	-541.6	-613.5	-633.2	-648.4	-693.8	-687.3

Burimi: ASK




Përdorimi i tokës

Shfrytëzimi i tokës bujqësore

	2016	2017	2018	2019	2020
Tokë e punueshme - ara	187,223	186,954	188,359	188,365	188,372
- Nga e cila me perime në fushë të hapur (kulturë e parë)	7,864	8,033	7,818	8,319	8,435
- Nga e cila me perime në serra (kulturë e parë)	457	467	468	518	547
Kopshte	994	1,199	1,003	1,122	1,133
Plantacione të pemëve	5,493	6,247	7,687	9,244	10,029
Plantacione të vreshtave	3,112	3,199	3,272	3,367	3,437
Fidanishte	196	159	109	111	137
Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët)	218,808	218,314	218,152	217,932	217,102
Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore	415,826	416,072	418,582	420,141	420,210


Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore '16,'17,'18,'19,'20

Klasat e përdorimit të tokës në Kosovë



Burimi: Inventarizimi Nacional i Pyjeve INP, 2012

Shfrytëzimi i tokës bujqësore, 2020



Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore, 2020

Madhësia e fermës

Madhësia e fermës	Numri i ekonomive bujqësore					Sipërfaqja e tokës së punueshme (ha)				
	2016	2017	2018	2019	2020	2016	2017	2018	2019	2020
0 ≤ 0.5	33,312	39,251	31,648	32,020	31,290	5,677	5,976	5,801	5,929	6,453
0.5 ≤ 1	22,340	18,543	19,508	18,355	17,560	14,603	12,584	12,718	12,065	11,999
1 ≤ 2	25,086	22,323	24,522	23,022	22,560	33,384	29,898	32,096	30,123	29,005
2 ≤ 5	21,792	20,460	21,359	24,231	23,383	64,877	59,696	63,042	65,202	38,665
5 ≤ 10	4,531	5,712	5,719	6,013	7,063	29,498	37,458	38,085	39,533	64,819
10 ≤ 20	1,253	1,331	1,342	1,203	1,429	16,258	17,219	17,347	16,013	16,800
20 ≤ 30	223	226	240	245	240	5,300	5,332	5,717	5,146	5,255
≥ 30	263	263	194	200	198	16,109	16,967	12,201	13,016	13,393
Gjithsej	108,800	108,108	104,532	105,289	103,723	185,705	185,130	187,007	187,026	186,389

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore '16,'17,'18,'19,'20

*Nuk janë përfshirë EB të komunave veriore

Llogaritë ekonomike

Prodhimet e industrisë bujqësore me çmime aktuale, mil. €	2016	2017	2018	2019	2020
Prodhimet bimore	412.3	402.5	388.3	441.0	477.4
Drithërat	103.7	83.3	84.8	96.8	116.1
Bimët foragjere	87.5	107.6	106.5	113.9	121.0
Perimet dhe prodhimet e kopshtit	122.2	120.3	98.6	123.1	109.1
Patatet	30.5	36.7	27.8	24.3	27.1
Pemët	63.7	50.1	66.5	78.6	99.9
Prodhime tjera bimore	4.3	4.3	4.0	4.2	4.1
Blegtoaria	160.5	157.4	140.3	164.7	164.6
Gjedhe	91.3	93.4	73.7	91.0	67.8
Dele dhe dhi	19.4	20.4	21.0	23.3	27.2
Derra	16.1	13.4	16.5	13.8	18.4

Shpezë	22.9	19.0	15.3	17.4	24.0
Kafshë të tjera	10.9	11.2	14.2	19.1	27.2
Produktet blegtorale	137.5	141.0	132.0	129.3	137.9
Qumësht	108.6	109.8	103.2	101.3	107.7
Veze	28.9	31.2	28.2	28.0	30.1
Produktet tjera blegtorale	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1

Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '16,'17,'18,'19,'20

Komponentët kryesor të llogarive ekonomike me çmime bazike, mil. €

	2016	2017	2018	2019	2020
Prodhimet e "industrisë" bujqësore	741.9	734.4	704.7	782.3	828.4
Konsumi i ndërmjetëm	256.9	270.6	302.0	305.4	316.3
Vlera e shtuar bruto	485.0	463.8	402.7	476.9	512.1
Konsumi i kapitalit fiks	102.4	105.4	108.2	116.7	121.0
Vlera e shtuar neto	382.5	358.3	294.4	360.3	391.1
Subvencionet tjera në prodhim	1.0	0.1	2.1	0.3	0.2
Të ardhurat faktor	383.5	358.4	296.5	360.6	391.1
Të ardhurat sipërmarrëse	375.0	349.1	280.5	343.5	376.0

Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '16,'17,'18,'19,'20

Çmimet e inpueteve dhe produkteve bujqësore

Indeksi i çmimeve të inpueteve bujqësore					
	2016	2017	2018	2019	2020
Mallrat dhe shërbimet e konsumuara aktualisht në bujqësi (Input 1)	98.1	95.4	94	95.8	92.7
Farërat dhe materiali mbëltues	98.9	87.2	78.1	83.7	84.2
Energji; lubrifikant	93.7	100.9	106.5	106.3	92.0
Plehrat dhe përmirësuesit e tokës	97.6	89.5	85.9	88.5	87.3
Produktet për mbrojtjen e bimëve dhe pesticidet	104.2	103.8	105.4	106.3	103.5
Shpenzimet veterinare	98.7	98.0	97.5	99.3	98.0
Lëndë për ushqim kafshësh	109.5	103.7	103.2	107.6	110.1
Mirëmbajtja e materialeve	100.1	99.9	99.8	99.5	99.2
Mirëmbajtja e ndërtesave	98.2	98.8	98.6	99.3	101.5
Mallrat dhe shërbimet tjera	100.0	100.8	100.9	101.4	101.3
Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore (Input 2)	102.5	103.5	102.6	109.9	111.5
Traktor	106.9	107.7	105.2	119.0	120.8
Të tjera	98.5	99.8	100.3	101.8	103.3
Inputi i përgjithshëm (Input 1 + input 2)	100.1	99	97.8	102.1	101.1

Burimi: ASK - Indeksi i çmimeve të inpueteve dhe çmimet në bujqësi 2016-2020 (2015=100), përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Çmimet vjetore për energji elektrike dhe naftë, €					
	2016	2017	2018	2019	2020
Energjia elektrike çmimi për 100 kwh	6.1	6.4	5.8	5.6	5.6
Nafta - çmimi për 100 litra	93.5	102.1	112.7	114.9	92.6

Burimi: ASK - Indeksi i çmimeve të inpueteve dhe çmimet në bujqësi 2016-2020

Çmimet e prodhimeve bujqësore

Çmimet mesatare vjetore në fermë, €/kg					
	2016	2017	2018	2019	2020
Grurë	0.27	0.21	0.23	0.18	0.19
Misër	0.11	0.13	0.16	0.14	0.08
Domate	0.64	0.54	0.62	0.57	0.33
Fasule	2.45	2.29	2.27	2.03	2.31
Kungull *	0.78	0.94	0.90	0.81	0.24
Kungull misiri *	0.68	0.71	0.84	0.81	0.22
Lakër	0.19	0.19	0.40	0.19	0.23
Patate	0.32	0.30	0.33	0.28	0.28
Qepë	0.24	0.32	0.37	0.46	0.37
Shalqi	0.18	0.10	0.23	0.19	0.23
Spec	1.12	0.59	0.91	0.76	0.54
Spinaq	0.95	0.71	0.94	0.94	0.91
Trangull	0.55	0.42	0.46	0.48	0.43
Arrë	2.32	2.64	2.72	2.16	2.06
Dardhë	0.62	0.80	0.79	0.81	0.72
Dredhëz	0.88	1.08	1.03	1.12	1.15
Kumbull	0.48	0.70	0.73	0.51	0.68
Mjedër	2.90	2.94	1.67	1.77	1.73
Mollë	0.47	0.49	0.40	0.39	0.32
Rrush tryeze	0.48	0.74	0.78	0.68	0.65
Mëzet dhe Mëshqerra	2.02	1.88	2.14	1.97	2.23
Pulë ferme	1.39	1.47	1.80	1.68	1.73
Qumësht	0.23	0.27	0.25	0.21	0.23
Vezë**	2.55	2.45	2.10	2.07	2.26
Mjaltë	8.80	7.10	9.20	11.85	13.50

Burimi: DAESB - MBPZhr; *2016-2019 €/copë, 2020 €/kg, **njësia 30 copë

Çmimet mesatare vjetore të konsumit, €/kg	2016	2017	2018	2019	2020
Grurë	0.29	0.26	0.28	0.36	0.38
Misër	0.16	0.18	0.23	0.38	0.22
Domate	0.80	0.71	0.84	0.80	0.77
Fasule	2.76	2.56	2.64	2.66	2.60
Kungull *	0.94	1.10	1.19	1.16	0.42
Kungull misiri *	1.08	1.38	1.26	1.22	0.45
Lakër	0.24	0.32	0.59	0.55	0.47
Patate	0.45	0.38	0.43	0.50	0.48
Qepë	0.29	0.41	0.47	0.65	0.64
Shalqi	0.26	0.19	0.40	0.30	0.45
Spec	1.41	0.89	1.17	1.06	1.08
Spinaq	1.21	0.84	1.12	1.18	1.07
Trangull	0.73	0.56	0.61	0.67	0.65
Arrë	2.57	2.92	2.89	2.61	2.56
Dardhë	0.71	1.24	0.94	1.13	1.35
Dredhëz	1.00	2.02	1.89	1.49	1.97
Kumbull	0.61	0.90	0.84	0.75	0.79
Mjedër	3.47	3.48	2.60	2.44	2.26
Mollë	0.62	0.63	0.53	0.60	0.74
Rrush tryeze	0.63	1.10	1.09	0.98	1.09
Mëzet dhe Mëshqerra	3.65	3.70	3.80	3.75	3.02
Pulë ferme	2.24	2.26	2.37	2.33	2.13
Qumësht	0.48	0.47	0.49	0.51	0.48
Veze**	2.79	2.58	2.45	2.50	2.61
Mjaltë	8.58	8.39	7.50	7.40	16.55

Burimi: DAESB - MBPZhR; *2016-2019 €/copë, 2020 €/kg, **njësia 30 copë

Çmimet mesatare të importit në treg, €/kg	2016	2017	2018	2019	2020
Grurë	0.27	0.24	0.31	0.38	0.38
Misër	0.17	0.18	0.18	0.25	0.22
Domate	0.93	0.90	0.91	0.97	1.19
Fasule	2.19	2.32	2.03	1.97	2.01
Kungull *	0.98	0.79	1.18	1.12	0.28
Kungull misiri *	1.15	1.14	1.50	0.90	0.46
Lakër	0.40	0.33	0.39	0.56	0.64
Patate	1.06	0.77	0.66	0.55	0.84
Qepë	0.38	0.36	0.39	0.52	0.61
Shalqi	0.77	1.03	0.96	1.61	0.85
Spec	1.46	1.28	1.18	1.46	1.50
Spinaq	1.48	1.14	1.15	1.49	1.19
Trangull	1.04	1.06	0.94	1.08	1.21
Arrë	2.05	2.38	2.44	2.40	2.06
Dardhë	0.94	1.30	1.28	1.34	1.47
Dredhëz	3.78	4.33	2.96	2.69	2.94
Kumbull	3.36	2.92	2.83	3.49	2.34
Mjedër	-	-	-	1.70	-
Mollë	0.69	0.68	0.83	0.78	0.82
Rrush tryeze	2.14	2.66	2.45	2.66	1.97
Mëzet dhe Mëshqerra	2.62	2.77	2.90	3.05	2.87
Pulë ferme	2.20	1.90	2.60	2.35	2.21
Veze **	1.90	2.25	2.10	2.35	2.15
Mjaltë	7.90	8.85	8.60	7.85	8.60

Burimi: DAESB - MBPZHR; *2016-2019 €/copë, 2020 €/kg, **njësia 30 copë

FADN - Rrjeti i të dhënave të kontabilitetit në fermë

Lloji dhe madhësia e fermës			
Nr.	Lloji i fermës	Nr.	Madhësia e fermës (SO në €)
1	Të specializuara në kultura lavërtare	1	2,000 - < 4,000
2	Të specializuara në hortikulturë (serra)	2	4,000 - < 8,000
3	Të specializuara në kultura shumëvjeçare	3	8,000 - < 25,000
4	Të specializuara në bagëti që kullosin	4	25,000 - < 50,000
5	Të specializuara me granivore	5	50,000 - < 100,000
6	Kultura të përziera	6	100,000 - < 500,000
7	Ferma të përziera blegtorale	7	≥ 500,000
8	Ferma të përziera me kultura dhe bagëti		

Burimi: FADN, DAESB – MBPZhR

Rezultatet standarde të FADN-së në nivel vendi						
Variabla	Njësia	2016	2017	2018	2019	
Sipërfaqja bujqësore e shfrytëzuar (SE025)	ha	4.20	3.92	3.50	3.52	
Njësitë blegtorale (SE080)	njb*	3.07	2.83	2.87	2.98	
Fuqia punëtore e paguar (SE020)	njvp**	0.06	0.08	0.09	0.12	
Fuqia punëtore e papaguar (SE015)	njvp	0.92	0.97	1.30	1.70	
Outputi (SE131)	€	8,847.00	7,834.00	7,773.00	9,712.06	
Outputi i prodhimeve bimore (SE135)	€	3,767.98	3,602.64	3,002.56	3,155.64	
Outputi i prodhimeve shtazore (SE206)	€	4,938.81	4,073.53	4,260.09	5,001.41	
Outputet tjera (SE256)	€	140.05	157.97	510.30	1,555.00	
Inputet (SE270)	€	6,623.82	5,732.28	6,342.08	7,633.00	
Konsumi i ndërmjetëm (SE275)	€	5,272.45	4,597.57	4,771.94	5,810.29	
Vlera e shtuar neto e fermës/njvp (SE425)	€/njvp	3,053.34	2,702.21	1,551.94	1,608.38	

Burimi: FADN, DAESB - MBPZhR

*njb - njësi blegtorale, **njvp - njësi vjetore e punës

Rezultatet standarde të FADN-së sipas madhësisë ekonomike ('000), 2019							
Variabla	Njësia	2≤4	4≤8	8≤25	25≤50	50≤100	≥100
Sipërfaqja bujqësore e shfrytëzuar (SE025)	ha	1.72	3.02	5.41	9.48	11.01	28.45
Njësitë blegtorale (SE080)	njb	1.20	2.06	4.45	9.95	7.79	77.16
Fuqia punëtore e paguar (SE020)	njvp	0.02	0.06	0.21	0.41	1.10	2.46
Fuqia punëtore e papaguar (SE015)	njvp	1.41	1.71	2.05	2.39	2.51	2.85
Outputi (SE131)	€	3,808.70	6,930.45	14,565.04	27,182.83	63,555.25	123,912.07
Outputi i prodhimeve bimore (SE135)	€	1,067.75	2,058.55	4,905.43	10,430.73	22,456.66	37,390.90
Outputi i prodhimeve shtazore (SE206)	€	2,239.96	4,134.76	7,821.89	14,068.42	11,792.56	78,471.36
Outputet tjera (SE256)	€	500.98	737.13	1,837.71	2,683.66	29,306.02	8,049.80
Inputet (SE270)	€	3,541.96	5,969.70	10,977.11	21,728.48	34,422.48	98,103.83
Konsumi i ndërmjetëm (SE275)	€	2,485.68	4,483.34	8,627.72	16,328.71	27,694.60	81,850.91
Vlera e shtuar neto e fermës/njvp (SE425)	€/njvp	318.05	770.92	2,232.62	3,240.27	9,776.67	8,070.71

Burimi: FADN, DAESB - MBPZhR

Rezultatet standarde të FADN-së sipas tipit të fermës, 2019									
Variabla	Njësia	Të specializuar a në kultura lavërtare	Të specializuar a në hortikulturë-serra	Të specializuara në kultura shumëvjeçare	Të specializuar a në bagëti që kullosin	Të specializuar a në granivore	Të specializuar a me kultura të përziara	Ferma të përziara blegtorale	Ferma të përziara me kultura dhe blegtori
Sipërfaqja bujqësore e shfrytëzuar (SE025)	ha	4.18	1.70	2.46	4.01	1.06	2.76	3.22	3.53
Njësitë blegtorale (SE080)	njb	0.75	0.37	0.36	5.82	13.23	0.92	4.23	2.66
Fuqia punëtore e paguar (SE020)	njvp	0.13	0.81	0.36	0.08	0.14	0.20	0.11	0.07
Fuqia punëtore e papaguar (SE015)	njvp	1.52	1.99	1.29	1.96	1.24	1.56	1.91	1.76

Outputi (SE131)	€	6,959.58	13,883.61	8,016.69	16,037.08	13,407.03	6,274.68	9,702.66	9,241.23
Outputi i prodhimeve bimore (SE135)	€	4,357.47	12,990.66	4,145.39	2,709.80	1,000.71	3,658.78	2,073.58	2,703.94
Outputi i prodhimeve shtazore (SE206)	€	1,409.80	689.26	467.66	9,371.16	12,144.99	1,741.98	7,060.30	5,364.81
Outputet tjera (SE256)	€	1,192.30	203.68	3,403.62	3,956.10	261.32	873.92	568.78	1,172.47
Inputet (SE270)	€	5,971.85	6,824.74	6,359.28	10,889.54	10,923.65	6,249.04	7,742.08	7,430.79
Konsumi i ndërmjetëm (SE275)	€	4,031.88	3,176.26	4,598.02	8,935.64	9,066.22	3,948.85	5,977.15	5,825.22
Vlera e shtuar neto e fermës/njvp (SE425)	€/njvp	1,166.88	3,483.86	2,120.47	2,898.11	2,409.69	637.85	1,346.07	1,356.87

Burimi: FADN, DAESB – MBPZhR

Prodhimi bujqësor dhe blegtoral

Prodhimet bimore, ha					
	2016	2017	2018	2019	2020
Drithëra	134,571	120,746	123,869	124,199	124,714
Grurë	89,122	80,519	81,123	80,273	80,473
Misër	41,524	35,951	38,453	39,441	39,684
Perime	17,395	19,643	17,886	18,911	19,243
Patate	3,795	4,290	3,606	3,688	3,771
Spec	3,363	3,035	3,038	3,108	3,134
Fasule	3,317	3,406	2,845	2,888	2,904
Kungull	1,017	2,270	2,255	2,502	2,577
Pemishte	5,668	6,422	7,922	9,479	10,265
Molla	2,076	2,155	2,556	3,006	3,068
Kumbulla	1,518	1,524	1,821	2,096	2,201
Mjedra	797	1,231	1,537	1,637	1,661
Arra	186	340	608	886	1,295
Vreshta	3,117	3,199	3,272	3,367	3,437
Rrush vere	2,348	2,400	2,455	2,489	2,526

Rrush tryeze	769	799	816	878	911
Kultura foragjere	97,936	105,613	107,099	108,480	108,436
Sanë	69,021	69,235	70,679	70,679	70,717
Jonxhë	15,190	15,747	17,182	18,293	18,329
Kultura industriale	389	450	329	402	1,065

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore '16,'17,'18,'19, '20; MBPZhR - Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari (DVV)

Prodhimtaria bimore, t					
	2016	2017	2018	2019	2020
Drithëra	562,899	477,880	441,757	459,404	529,112
Grurë	365,651	320,136	280,616	284,999	341,818
Misër	186,592	147,200	151,921	163,930	175,180
Perime	335,467	358,394	265,420	300,559	290,555
Patate	98,583	118,250	68,790	73,816	74,508
Spec	68,849	62,934	49,907	59,404	53,889
Fasule	10,267	8,687	5,688	6,713	5,708
Kungull	14,894	25,564	20,208	23,050	22,535
Pemishte	54,836	34,207	53,606	67,294	72,265
Molla	27,485	13,159	26,093	33,835	38,049
Kumbulla	12,722	7,393	10,643	12,745	13,147
Mjedra	6,250	7,747	8,267	7,206	6,659
Arra	470	405	761	2,028	2,591
Vreshta	23,666	15,364	27,322	19,318	26,330
Rrush vere	16,800	12,177	22,324	14,772	20,049
Rrush tryeze	6,866	3,187	4,998	4,546	6,281
Kultura foragjere	390,707	486,989	480,966	504,406	503,758
Sanë	225,813	226,288	249,559	249,683	247,921
Jonxhë	63,522	67,748	73,754	84,257	85,503
Kultura industriale	1,028	514	392	576	1,347

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore '16,'17,'18,'19,'20; DVV - MBPZhR

Prodhimtaria bimore, t/ha		2016	2017	2018	2019	2020
Drithëra	Grurë	4.10	3.98	3.46	3.55	4.25
	Misër	4.49	4.09	3.95	4.16	4.41
Perime	Patate	25.97	27.56	19.08	20.01	19.76
	Spec	20.47	20.74	16.43	19.11	17.19
	Fasule	3.10	2.55	2.00	2.32	1.97
	Kungull	14.65	11.26	8.96	9.21	8.74
Pemishte	Molla	13.24	6.11	10.21	11.25	12.40
	Kumbulla	8.38	4.85	5.84	6.08	5.97
	Mjedra	7.84	6.30	5.38	4.40	4.01
	Arra	2.52	1.19	1.25	2.29	2.00
Vreshta	Rrush tryeze	8.93	3.99	6.13	5.18	6.90
	Rrush vere	7.16	5.07	9.09	5.93	7.90
Kultura foragjere	Sanë	3.27	3.27	3.53	3.53	3.51
	Jonxhë	4.18	4.30	4.29	4.61	4.66

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore '16,'17,'18,'19,'20; DVV - MBPZhR

Prodhimi i verës, '000 litra		2016	2017	2018	2019	2020
Verë e bardhë		3,613	2,024	6,234	3,380	5,100
Verë e kuqe		5,446	1,455	5,441	2,325	4,295
Verë roze		59	1,826	69	49	35
Gjithsej verë		9,118	5,305	11,744	5,754	9,429

Burimi: DVV - MBPZhR

Prodhimtaria Organike

	2017	2018	2019	2020
Bimë mjekësore dhe aromatike, ha	170	424	480	1,040
Kompani të certifikuar	5	35	35	-
Zona të certifikuar, ha	824,379	373,488	373,488	-
Qendra të grumbullimit	45	45	45	-

Burimi: Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve (DPBT) - MBPZhR

Prodhimi i fidanëve të pemëve me nënshartesa vegjetative dhe gjenerative

	2016	2017	2018	2019	2020
Nënshartesa Vegjetative	477,303	947,310	448,060	500,267	-
Nënshartesa Gjenerative	134,995	92,260	104,705	123,000	-
Gjithsej	612,298	1,039,570	552,765	623,267	-

Burimi: DPBT - MBPZhR

Numri i kafshëve, shpezëve dhe bletëve

	2016	2017	2018	2019	2020
Gjedhe	264,971	259,729	258,662	257,733	261,389
Lopë qumështore	136,783	132,971	132,474	131,939	133,916
Dhen dhe dhi	212,040	210,688	209,808	216,299	241,688
Dhentë	184,265	182,278	181,105	189,102	212,131
Dele për mbarështim	141,995	136,810	139,312	145,248	159,067
Dhi	27,775	28,410	28,703	27,197	29,557
Dhi për mbarështim	24,315	24,836	22,401	20,602	21,907
Derra	42,309	41,086	40,164	40,533	45,394
Dosa	11,469	10,281	10,188	11,422	12,756
Shpezë ('000)	2,740	2,811	2,538	2,665	2,782
Pula ('000)	2,586	2,676	2,393	2,558	2,637
Pula për vezë ('000)	2,043	2,051	1,728	1,947	1,939

Brojler ('000)	196	398	407	321	384
Koshere bletësh	162,355	163,717	182,476	219,831	262,541

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore '16,'17,'18,'19,'20

Prodhimtaria blegtorale, t					
	2016	2017	2018	2019	2020
Mish gjedhi (p.th)	19,985	19,835	19,463	19,495	19,738
Mish pule (p.th)	2,439	3,500	3,023	2,508	2,671
Qumësht lope	285,261	277,976	277,599	277,138	281,960
Vezë ('000 copë)	350,827	348,998	315,097	366,447	365,554
Mjaltë	568	982	2,737	2,198	788

Burimi: DAESB - MBPZhR

Bilancet e furnizimit për prodhime bujqësore

Konsumi për kokë banori për disa prodhime bujqësore, kg		2016	2017	2018	2019	2020
Drithëra	Grurë	233.4	212.9	200.3	231.9	204.0
	Misër	49.2	46.3	44.7	47.0	49.4
Perime	Patate	49.7	61.5	34.8	40.0	38.7
	Spec	43.4	38.8	33.0	37.9	33.4
	Domate	23.9	21.9	21.5	20.7	19.4
Pemishte	Molla	22.1	15.1	19.1	23.7	27.0
	Kumbulla	8.2	4.9	6.6	8.3	8.5
	Dredhëz	1.0	1.0	1.1	1.5	1.1
Vreshta	Rrush tryeze	5.3	3.7	4.1	4.5	4.9
	Mish gjedhi	18.2	18.0	19.3	20.1	21.0
Mish	Mish i deles dhe dhisë	1.2	1.2	1.2	1.2	-
	Mish pule	21.5	20.6	21.1	22.9	20.9

Produkte tjera	Qumësht lope	171.7	166.2	167.8	171.8	169.6
	Vezë (copë)	200.5	196.3	177.8	208.5	206.0
	Mjaltë	0.4	0.7	1.6	1.4	0.6

Burimi: DAESB - MBPZHR


Shkalla e vetëmjaftueshmërisë për disa prodhime bujqësore (%)

		2016	2017	2018	2019	2020
Drithëra	Grurë	69.9	67.1	63.0	57.0	73.3
	Misër	77.3	71.7	73.9	74.8	75.1
Perime	Patate	111.0	106.6	109.7	103.2	106.7
	Spec	86.6	87.7	82.0	85.6	87.2
	Domate	62.6	61.5	57.5	59.8	56.9
Pemishte	Molla	69.1	48.1	75.7	79.3	77.7
	Kumbulla	96.8	92.6	99.6	95.5	95.1
	Dredhëz	84.2	79.1	75.0	69.1	78.5
Vreshta	Rrush tryeze	73.2	47.5	67.7	57.0	71.0
	Mish gjedhi	61.9	61.1	56.1	54.0	52.2
Mish	Mish i deles dhe dhisë	100.5	100.6	99.0	99.4	-
	Mish pule	6.4	9.5	8.0	6.1	7.1
	Qumësht lope	80.6	80.5	79.9	78.6	80.1
Produkte tjera	Vezë (copë)	98.1	98.9	98.7	98.6	99.0
	Mjaltë	74.0	83.3	92.9	90.6	76.0

Burimi: DAESB - MBPZHR

Tregtia e produkteve bujqësore


Ekspert, Importi dhe Bilanci tregtar i produkteve bujqësore (1-24), në mil. €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR


*Grupet e mallrave 01-24 të Nomenklaturës së Kombinuar

Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Eksporti i produkteve bujqësore sipas grupeve kryesore (%)

	Ø 2006-10	Ø 2011-15	2016	2017	2018	2019	2020
Eksporti (mil. €)	19.1	34.7	45.2	61.3	64.0	65.5	78.1
Mishi dhe përgatitja e mishit (CN 02 dhe CN 16)	0.5	0.8	1.6	1.3	1.4	1.8	2.8
Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral (CN 04)	1.4	0.7	1.1	0.8	0.7	1.2	1.1
Mbetjet nga industritë ushqimore; Ushqim foragjer (CN23)	1.6	2.5	2.0	1.7	1.9	1.1	1.4
Përgatitje të ndryshme të ngrënshme (CN 21)	0.8	0.6	1.0	0.6	1.0	0.9	0.8
Pijet, alkoolet dhe uthulla (CN 22)	23.1	34.6	37.6	39.4	43.1	43.8	38.0
Pemët dhe perimet e ngrënshme (CN 08 dhe CN 07)	22.6	15.7	19.1	22.0	22.5	19.8	23.8
Të tjera	50.0	45.0	37.7	34.1	29.3	31.4	32.2

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Importi i produkteve bujqësore sipas grupeve kryesore (%)

	Ø 2006-10	Ø 2011-15	2016	2017	2018	2019	2020
Importi (mil. €)	419.0	594.0	658.7	694.5	712.3	759.4	765.4
Pemët dhe perimet e ngrënshme (CN 08 dhe CN 07)	7.9	7.6	8.5	8.4	8.3	8.5	8.4
Mishi dhe përgatitja e mishit (CN 02 dhe CN 16)	12.7	13.5	12.6	12.9	12.9	13.7	12.1
Mbetjet nga industritë ushqimore; Ushqim foragjer (CN23)	2.9	2.9	2.9	2.7	2.8	2.1	2.7
Përgatitje të ndryshme të ngrënshme (CN 21)	6.4	7.8	8.9	9.2	9.6	9.8	9.9
Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral (CN 04)	7.0	6.3	6.3	6.5	6.7	6.6	6.6
Përgatitja nga drithërat, miell ose niseshte (CN 19)	7.9	8.4	9.2	9.1	9.1	8.7	9.1
Pijet, alkoolet dhe uthulla (CN 22)	11.8	10.2	10.7	10.8	10.8	10.6	10.0
Të tjera	43.4	43.3	41.0	40.5	39.9	39.9	41.1

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Eksporti i produkteve bujqësore sipas shteteve kryesore (%)

	Ø 2005-09	Ø 2010-14	2016	2017	2018	2019	2020
Eksporti (mil. €)	15.7	31.2	45.2	61.3	64.0	65.5	78.1
Bullgari	1.5	0.4	2.0	2.4	2.8	2.8	3.5
Gjermani	10.4	6.6	7.0	13.2	12.9	11.6	14.9
Maqedoni e Veriut	19.9	16.3	11.5	11.7	12.5	12.9	12.1
Serbi	14.7	6.7	10.3	8.6	9.8	9.1	7.9
Shqipëri	31.2	41.4	37.3	34.7	33.4	31.8	29.0
Zvicër	0.7	1.8	2.7	3.1	2.9	2.8	3.1
Të tjera	21.7	26.8	29.2	26.2	25.8	29.1	29.5

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Importi i produkteve bujqësore sipas shteteve kryesore (%)

	Ø 2005-09	Ø 2010-14	2016	2017	2018	2019	2020
Importi (mil. €)	379.5	563.8	658.7	694.5	712.3	759.4	765.4
Bullgari	3.8	3.0	1.9	1.9	2.1	6.5	4.7
Gjermani	3.9	8.4	8.2	7.3	7.0	7.8	7.3
Kroaci	4.1	3.7	3.7	3.9	4.2	7.7	6.6
Maqedoni e Veriut	12.2	8.2	6.2	6.1	6.4	10.1	8.0
Poloni	2.2	2.9	6.5	6.3	6.7	7.5	6.8
Turqi	7.3	6.2	6.4	6.4	7.0	7.5	7.6
Të tjera	66.6	67.5	67.1	68.1	66.6	52.9	58.9

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Agro kreditë

Agro Kredi 2016 - 2020	Numri i kredive të disbursuara	Shuma totale e kredive të disbursuara (mil. €)	Kohëzgjatja e kredisë (muaj)	Norma mesatare e interesit (%)	Pjesëmarrja e Agro Kredive në gjithsej kreditë (%)
2016	19,086	81.4	12 - 42	8.0 - 26.9	0.5 - 60.0
2017	24,940	91.3	17 - 39	7.3 - 26.7	0.3 - 43.0
2018	26,403	91.3	12 - 39	6.0 - 28.5	1.3 - 64.5
2019	21,622	115.1	18 - 42	6.4 - 28.4	0.7 - 43.5
2020	22,958	83.2	18 - 40	5.3 - 28.6	0.5 - 36.7
Gjithsej	115,009	462.4			

Burimi: Bankat komerciale dhe IMF në Kosovë, përpunuar nga DAESB - MBPZHR


Përkrahja e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural

Pagesat direkte dhe grantet në mil. €	2016	2017	2018	2019	2020
Pagesa direkte	26.1	27.0	29.6	30.6	67.1
Grante	22.5	15.4	31.0	16.1	12.6
Gjithsej	48.6	42.5	60.6	46.7	79.7

Burimi: AZhB, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Pagesa direkte

Njësitë e mbështetura përmes pagesave direkte në vitin 2020



Burimi: AZhB, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Pagesat direkte për kulturat bujqësore, verë dhe fidane

	2016	2017	2018	2019	2020	
Grurë	Numri i aplikuesve	11,864	9,709	10,683	8,872	11,044
	Numri i përfituesve	11,602	9,216	10,311	8,698	10,729
	Numri i ha të paguar	50,180	38,542	43,673	35,287	46,931
	Pagesa për ha	150	150	150	150	300
	Shuma totale e paguar	7,526,999	5,781,300	6,550,929	5,292,996	14,079,396
Farë gruri	Numri i aplikuesve	25	11	11	15	25
	Numri i përfituesve	25	11	11	15	24
	Numri i ha të paguar	803	508	458	562	869
	Pagesa për ha	250	250	250	250	500
	Shuma totale e paguar	196,678	122,003	114,204	140,395	434,540
Misër	Numri i aplikuesve	7,985	8,598	8,432	9,526	10,020
	Numri i përfituesve	7,763	8,231	8,165	9,370	9,808
	Numri i ha të paguar	19,140	22,077	21,519	27,483	28,493
	Pagesa për ha	150	150	150	150	300
	Shuma totale e paguar	2,870,969	3,311,579	3,227,784	4,122,464	8,547,885
Elb	Numri i aplikuesve	151	227	316	273	242
	Numri i përfituesve	133	208	306	267	233
	Numri i ha të paguar	251	387	518	488	442
	Pagesa për ha	100	100	150	150	300
	Shuma totale e paguar	25,118	38,662	77,688	73,194	132,645
Thekër	Numri i aplikuesve	77	78	83	70	59
	Numri i përfituesve	61	67	72	67	56
	Numri i ha të paguar	200	170	196	196	195
	Pagesa për ha	100	100	150	150	300
	Shuma totale e paguar	19,977	16,957	29,343	29,423	58,623
Tërshërë	Numri i aplikuesve	-	-	-	505	569
	Numri i përfituesve	-	-	-	485	538
	Numri i ha të paguar	-	-	-	928	1,321

	Pagesa për ha	-	-	-	150	300
	Shuma totale e paguar	-	-	-	139,161	396,261
Vreshta	Numri i aplikuesve	2,980	2,969	3,012	2,939	2,919
	Numri i përfituesve	2,881	2,909	2,949	2,900	2,880
	Numri i ha të paguar	2,473	2,508	2,580	2,989	3,080
	Pagesa për ha	1,000/400	1,000/500	1,000	1,000	2,000
	Shuma totale e paguar	2,117,978	2,266,235	2,580,250	2,988,810	6,160,400
Luledielli	Numri i aplikuesve	2	7	5	11	5
	Numri i përfituesve	2	6	4	11	3
	Numri i ha të paguar	9	53	5	97	40
	Pagesa për ha	150	150	150	150	300
	Shuma totale e paguar	1,316	7,946	749	14,621	12,036
Perime	Numri i aplikuesve	5,304	5,716	6,664	7,270	4,676
	Numri i përfituesve	5,188	5,550	6,435	7,099	4,481
	Numri i ha të paguar	6,605	7,481	8,977	8,295	9,210
	Pagesa për ha	300	300	300	300	600
	Shuma totale e paguar	1,981,617	2,244,228	2,693,021	2,488,506	5,525,712
Pemishte ekzistuese	Numri i aplikuesve	2,908	4,358	5,278	3,557	3,166
	Numri i përfituesve	2,794	4,110	5,097	3,488	3,034
	Numri i ha të paguar	2,780	3,999	4,764	4,142	4,757
	Pagesa për ha	400	400	400	400	800
	Shuma totale e paguar	1,112,032	1,599,496	1,905,548	1,656,812	3,805,736
Bujqësi organike	Numri i aplikuesve	7	10	37	27	48
	Numri i përfituesve	3	6	24	26	38
	Numri i ha të paguar	73	118	443	1,050	1,672
	Pagesa për ha	200	300	500	500	1,000
	Shuma totale e paguar	14,626	35,373	277,578	524,900	1,672,210
Verë	Numri i aplikuesve	-	18	16	15	18
	Numri i përfituesve	-	7	14	15	17
	Numri i litrave të paguara	-	1,375,607	4,769,358	9,734,385	5,711,290

	Pagesa për litër	-	0	0	0	0
	Shuma totale e paguar	-	55,024	190,774	389,375	228,452
Mjedër	Numri i aplikuesve	-	-	-	967	525
	Numri i përfituesve	-	-	-	594	386
	Numri i kg të paguara	-	-	-	898,547	1,055,337
	Pagesa për kg	-	-	-	0	0
	Shuma totale e paguar	-	-	-	71,883	168,854
Fidane	Numri i aplikuesve	17	16	16	14	13
	Numri i përfituesve	17	14	15	11	13
	Numri i fidaneve të paguara	431,414	406,045	483,230	435,200	469,194
	Pagesa për fidan	0.10/0.15/0.20	0.10/0.15/0.20	0.10/0.15/0.20	0.10/0.15/0.20	0.10/0.15/0.20
	Shuma totale e paguar	76,933	68,459	82,046	69,600	155,495
Bimë mjekësore dhe aromatike	Numri i aplikuesve	-	-	-	-	84
	Numri i përfituesve	-	-	-	-	70
	Numri i ha të paguara	-	-	-	-	248
	Pagesa për ha	-	-	-	-	450
	Shuma totale e paguar	-	-	-	-	111,479
Sigurimi bujqësor	Numri i aplikuesve	-	-	-	-	9
	Numri i përfituesve	-	-	-	-	5
	Numri i polisave të subvencionuara	-	-	-	-	5
	Pagesa për polisë, %	-	-	-	-	100
	Shuma totale e paguar	-	-	-	-	1,769

Burimi: AZhB, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Masat e zhvillimit rural

Numri i aplikacioneve të miratuara					
	2016	2017	2018	2019	2020
Masa 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	341	321	383	303	217
Masa 103: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	27	5	27	7	20
Masa: Ujitje e tokave bujqësore	7	1	3	2	1
Masa 302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	97	90	130	150	125
Masa 303: Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale-qasja Leader	11	0	13	11	-
Programi i veçantë	-	-	62	-	-
Gjithsej	483	417	618	473	363

Burimi: AZhB, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Vlera e miratuara në €					
	2016	2017	2018	2019	2020
Masa 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	15,234,339	12,790,578	16,897,514	12,035,806	7,138,627
Masa 103: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	4,661,782	959,024	4,842,579	1,281,799	3,689,237
Masa: Ujitje e tokave bujqësore	965,614	64,871	475,413	320,000	160,000
Masa 302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	1,561,820	1,632,494	2,259,156	2,188,065	1,639,936
Masa 303: Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale-qasja Leader	79,850	-	293,087	240,184	-
Programi i veçantë	-	-	6,201,729	-	-
Gjithsej	22,503,406	15,446,966	30,969,478	16,065,854	12,627,800

Burimi: AZhB, përpunuar nga DAESB - MBPZhR